



Departamenti i Prokurimit

Prishtinë: datë 22.12.2020

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Prishtinës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 22.12.2020 të parashtruar nga Operatori Ekonomik "Olti &Kenza" Shpk" për aktivitetin: "**Furnizim me dhurata te Vitit te Ri per Komunen e Prishtines**" dhe me numër të prokurimit: 616 20 181 136 nxjerr:

V E N D I M

1. Refuzohet kërkesa për ri-shqyrtim e Operatorit Ekonomik "Olti &Kenza" Shpk" e datës 22.12.2020 lidhur me aktivitetin e prokurimit : "**Furnizim me dhurata te Vitit te Ri per Komunen e Prishtines**" me Nr. 616-20-8348-136, me Nr. Brendshëm : 616 20 181 136 .
2. Autoriteti Kontraktues, vendos që *ky aktivitet te vazhdohet sipas njoftimit te dates 17.12.2020.*
3. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën : <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

A r s y e t i m

Operatori Ekonomik "Olti &Kenza" Shpk" me datë 22.12.2020 ka parashtruar kërkesën për ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "**Furnizim me dhurata te Vitit te Ri per Komunen e Prishtines**" me numër të prokurimit Nr. . 616-20-8348-136 dhe numër të brendshëm 616 20 181 136 .

Autoriteti Kontraktues, me datë 22.12.2020, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë dhe ka konstatuar si vijon:

Sipas rregullave për tenderet jo normalisht të ulet asnjë nga tenderet e dorëzuar nuk ka cmim jo normalisht të ulet.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së. Ankesa pranë OSHP-se duhet të dorëzohet brenda 10 (dhjetë) diteve pas pranimi të këtij vendimi.


Zyrtari përgjegjës i Prokurimit